



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.871/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Ferki Xhaferi kryesues, Rrustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Obiliq Alban Nasufi nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Obiliqit, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 06.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr.871/2021 i datës 04.11.2021, paraqitur nga e kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Obiliq Alban Nasufi nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Obiliqit me të cilën ka kërkuar rinumërimin e fletëvotimeve në vendvotimet 1520E/01R 1520E/02D 1502E/02R 1502E/03R 1502E/04D dhe 1502E/01R.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 04.11.2021 nga e kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Obiliq Alban Nasufi nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Obiliqit, në të cilën pretendon se në vendvotimet 1520E/01R dhe 1520E/02D në Mazgit të Ulët dhe në vendvotimet 1502E/01R, 1502E/02R, 1502E/03R, 1502E/04D në fshatin Milloshevë në shkollën fillore “Hasan Prishtina”. I njëjti thekson se në këto vendvotime familjar dhe miq të tij pa imponim e kanë votuar atë.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pa bazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton se nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Obiliq Alban Nasufi nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Obiliqit, ka parashtruar apel ku ka kërkuar nga PZAP-i, që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve në vendvotimet: 1520E/01R 1520E/02D 1502E/02R 1502E/03R 1502E/04D dhe 1502E/01R.

Paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime gjatë numërimit të votave për kandidat të këtij subjekti politik, ashtu siç pretendon ankuesi, për faktin se thëniet e tij nuk mbështetën në asnjë provë konkrete por janë supozime sepse pritjet e ankuesit për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mospërputhje të rezultatit si dhe llogaritja matematikore nga ana e ankuesit nuk argumenton shkeljet e pretenduara në apel.

Paneli me rastin e vendosjes mori për bazë pretendimet e ankuesit se deklaratat e dorëzuar për VV-të e vendosura në dispozitiv të këtij vendimi janë dëshmimi se ka pasur vota në ato VV, poashtu për paneli është e qartë se në këto VV kandidati në fjalë ka pasur vota dhe të njëjtat vota janë publikuar me rastin e publikimit të rezultatit përfundimtar, por me asnjë provë shkresore ankuesi në VV e vendosur në dispozitiv nuk i ka argumentuar se ka parregullsi me rastin e publikimit të rezultatit apo ka me shumë vota sesa janë publikuar në rezultatin përfundimtar, prandaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.871/2021 më datën 06.11.2021

Kryesuesi i Panelit
Ferki Xhaferi



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 18 par. 4 të LZP-së në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.